



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 632 Prot.

Tiranë, më 24. 04. 2024

V E N D I M

Nr. 107, datë 24 ._04. 2024

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar², mori në shqyrtim ankesën Nr. 219 regj, datë 18.10.2023, të paraqitur nga znj.S.S, përfaqësuar me prokurë të posaçme nga z. P.S³ kundër Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”⁴, me pretendimin se është diskriminuar për shkak të “gjendjes familjare” dhe në kuadër të termit “çdo shkak tjetër”, për shkak të ankesës që ka paraqitur bashkëshorti i saj z. P.S kundër Universitetit.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e depozituar pranë Komisionerit, ankuesja S.S parashtron si vijon:

“Unë jam S.S dhe punoj si specialiste finance në Bashkinë Shkodër dhe pedagoge me kohë të pjeshme në Departamentin e Financë Kontabilitetit, pranë Fakultetit Ekonomik në Universitetin “Luigj Gurakuqi” (15 vite).

Në 15 vitet e punësimit si pedagoge e jashtme, kontratat janë nënshkruar në mënyrë automatike nga institucioni dhe nuk ka patur asnjë vonesë në firmosjen e tyre nga drejtuesit e Universitetit, përveç vitit të fundit. Në këto vite, nuk kam pasur asnjë ankesë për punën e zhvilluar si pedagoge e jashtme dhe kam marrë vlerësime maksimale nga studentët dhe nga stafi akademik i Departamentit të Financë-Kontabilitetit.

¹ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

² Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën LMD.

³ Prokurë e posaçme Nr.65 rep dhe nr.16 kol, datë 09.01.2024, hartuar para noteres B. Xh.T, Dhoma Kombëtare e Noterisë, Dega Vendore Shkodër.

⁴ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën USH.

Në shtator 2023, jam përjashtuar padrejhtësisht nga doktoratura dhe kam paraqitur ankesë sipas rregullores në fuqi. Në fillimin e vitit akademik kam paraqitur kërkesën për aktivizim sipas rregullores dhe jam shpallur fituese si pedagoge e jashtme në Departamentin e Financë-Kontabilitetit. Më vonë më ka kontaktuar shefja e departamentit dhe kam përcaktuar edhe ngarkesën që duhej të bëj këtë vit akademik.

Për shkak të ankesës, struktura drejtuese e universitetit nuk pranon të nënshkruaj kontratën e këtij viti akademik edhe pse jam shpallur fituese nga departamenti dhe jam kontaktuar disa herë për ngarkesën mësimore. Kjo është java e tretë e mësimit dhe nuk janë firmosur kontratat.

Arsyeja nuk është shkruar në mënyrë të qartë, por deklarohet se është një nen sipas të cilit nuk mund të jap mësim në të njëjtin departament ku është i punësuar edhe burri im, sipas ligjit të nepotizmit. Në fakt unë kam qenë e punësuar në këtë departament që në vitin 2008 dhe jam njohur me burrin tim gjatë punës në fakultet.

Në asnjë moment nuk kemi qenë në konflikt interesi, ndërsa ligji për nepotizmin është shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese që nga viti 2006. Një gjë të tillë e ka pranuar edhe Universiteti që e ka anashkaluar këtë pikë, por në këtë moment po e përdor vetëm për të më penalizuar për shkak të ankesës dhe besoj edhe për qëndrimet që ka mbajtur burri im kundrejt strukturave drejtuese. Mosfirmosja e kontratës ka ndodhur edhe vitin e kaluar me qëllim që të na përjashtojë nga doktoratura. Në vitin 2022 jam shpallur fituese për të nënshkruar kontratën, e cila pastaj nuk është firmosur në kohë. Si pasojë e mosfirmosjes së kontratës jam përjashtuar nga doktoratura dhe kam paraqitur ankesën e parë për diskriminim.”

Përfundimisht ankuesja kërkon nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit dhe detyrimin për firmosjen e kontratës si pedagoge e jashtme.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën, në referencë të kompetencës së parashikuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, që i jep të drejtën të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sikurse parashikohet në këtë ligj.

Ligji nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar (LMD), garanton mbrojtje nga diskriminimi bazuar në një listë të hapur shkaqesh si dhe duke garantuar në mënyrë të shprehur mbrojtje nga diskriminimi për shkak të gjendjes familjare. Në nenin 1 të LMD parashikohet se: **“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile,**

vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Në nenin 3/1, të LMD parashikohet se: “Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasoje pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”, ndërsa në nenin 12, “Ndalimi i diskriminimit”, pika 1, gëma “b”, të po këtij ligji, parashikohet: “Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: b) rekrutimin dhe përzgjedhjen e punëmarrësve; ”

Bazuar në nenin 7, pika 1, të LMD, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë, që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Sipas nenit 5, pika 1, të LMD, ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedure, si dhe çdo forme tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të LMD, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën nr.1128/1 prot., datë 30.10.2023, Komisioneri ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga USH, në cilësinë e subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa.
2. Me shkresën nr.3238/3 prot datë 09.11.2023, USH ka kthyer përgjigje në lidhje me ankesën. Në parashtrimet e sjella USH parashtron:

Së pari, ankesa është e njëjtë me ankesën nr.189, datë 26.09.2023. Pra, bëhet fjalë për një ankesë me të njëjtin objekt dhe shkak ligjor, të njëjtat palë, të njëjtat pretendime/parashtrime. KMD ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” i ndryshuar, neni 33 (Procedurat), duke pranuar regjistrimin e ankesës së dytë me nr.219 regj., datë 18.10.2023.

Po ashtu, referuar Kodit të Procedurave Administrative, i cili është i detyrueshëm për zbatim nga organet publike gjatë zhvillimit të një procesi administrativ, siç është rasti konkret, përcakton si më poshtë:

Neni 61 (Depozitime të tjera)

Rregullat e përcaktuara në këtë Kod për paraqitjen e kërkesës zbatohen edhe për paraqitjen e mendimeve, shpjegimeve, komenteve, deklaratave, si dhe dokumenteve të tjera, në kuadër të procedurës administrative.

Neni 64 pika 1 (E drejta e plotësimit, ndryshimit dhe e tërheqjes së kërkesës):

1. Një palë që ka dorëzuar një kërkesë mund ta plotësojë ose ndryshojë atë, vetëm kur qëllimi i kërkesës së ndryshuar bazohet në të njëjtën situatë faktike si kërkesa fillestare.

Pra, sa më lart, ankesa me nr.219 regj., datë 18.10.2023, duhej të ishte trajtuar sipas dispozitave të sipërcituara të K.Pr.Administrative dhe jo të regjistrohej si një ankesë e re, duke krijuar në këtë mënyrë, mbivendosje gjykimesh, vendimesh, e burokracie ndaj USH-së.

Së dyti, pretendimi i ankueses për diskriminim nga USH, për shkak të gjendjes familjare dhe për çdo shkak tjetër, duke lidhur arsyetimin me pasojën e mos-nënshkrimit të kontratës si pedagog e jashtme, nuk ka asnjë bazë ligjore mbështetëse apo prova të qëndrueshme, përveç hamendësimeve imagjinare (siç është nepotizmi).

Në parashtrimet e saj, ankuesja shprehet se: *“Arsyeja e mosnënshkrimit nuk është e qartë, por deklarohet se është një nen sipas të cilit nuk mund të jap mësim në të njëjtin departament ku është burri im, sipas ligjit për nepotizmin”* Ku rezulton të jetë dhënë ky deklaram, apo nga cili autoritet/strukturë drejtuese e USH-së? Kush e ka deklaruar verbalisht, apo cila është shkresa/e-mail, apo çdo formë tjetër ligjore e pranueshme si prove përpara Komisionerit që vërteton imagjinatën e ankueses. Vetë ankuesja shprehet se ka 15 vite punë si pedagog e jashtme në USH dhe tani pas 15 vitesh qënka USH që i përmend VKM-në e nepotizmit të shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese?

Pra, deklaratat e mësipërme të cilat mbështeten vetëm në hamendësime imagjinare, përbëjnë haptazi abuzim me të drejtën e ankimimit para Komisionerit, shkak tjetër ky për mospranimin e ankesës së depozituar.

Së treti, rezultati që do të arrijë ankuesja nëpërmjet KMD-së: *“Konstatimi i diskriminimit dhe detyrimin për firmosjen e kontratës”, sjellim në vëmendje Vendimin Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr.31, datë 14.04.2003, i cili ndër të tjera përcakton se : “...Nuk mund të detyrohet punëdhënësi me Vendim Gjyqësor të marrë në punë një individ”.*

Aq më tepër, në një interpretim analog, punëdhënësi nuk mund të detyrohet të marrë në punë një individ bazuar në një vendim të një organi publik.

Së katërti, bëjmë me dije KMD se, referuar nenit 45, të Statutit të USH-së përcaktohet se: *“Përzgjedhja e pedagogëve me kohë të pjesshme, bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara nga Njësia Bazë (Departamenti) por kjo procedurë duhet të jetë:*

- a) publike dhe transparente,
- b) konkurrese,

- c) nën mbikëqyrjen e Rektorit (i cili përderisa ka kompetenca për të shfuqizuar vendimet apo aktet e Dekanit dhe Shefit të Departamentit, si dhe për nënshkrimin e kontratave individuale, në emër dhe për llogari të punëdhënësit, sigurisht ka edhe kompetenca ligjore për të kontrolluar zbatimin e parimit të ligjshmërisë, nga çdo shkallë apo strukturë administrative vartëse e Universitetit që ka filluar, vazhduar dhe në shkelje të ligjit ka përfunduar procedurën konkurruese.)

Referuar procedurës që parashikon Udhëzimi me nr.371, datë 23.09.2016 i Rektorit të USH-së “Për procedurat e rekrutimit të pedagogëve me kohë të pjesshme”, rezulton se nga Fakulteti Ekonomik, nuk janë zbatuar përcaktimet e këtij Udhëzimi dhe për këtë arsye Rektori ka kthyer procedurën e përcjellë disa herë për të gjithë listën e kandidatëve të përcjellë.

Vetëm me datë 01.11.2023, Fakulteti Ekonomik ka përcjellë procedurat sipas ligjit dhe me datë 03.11.2023, dokumentacioni është përcjellë tek Zyra e Kurrikulave për certifikimin e ngarkesave mësimore të përcaktuara nga departamentet e FE-së, sipas procedurës së përgjithshme të ndjekur në çdo rast, përpara se të procedohet me nënshkrimin e kontratave për Stafin Akademik me kohë të Pjesshme.

Pas certifikimit të rregullshmërisë së ngarkesës mësimore nga Sektori i Kurrikulave, është proceduar me nënshkrimin e kontratave për të gjithë stafin akademik me kohë të pjesshme, përfshirë ankuesen S.S. Për rrjedhojë, objekti i ankesës së regjistruar pranë Komisionerit nuk ekziston më.

Sa më lart, kërkojmë nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi:

- Mospranimin e ankesës nr.219 regj datë 18.10.2023 për shkak të mungesës së mbështetjes ligjore të pretendimeve të ankueses dhe rënies së objektit të ankesës.

3. Me anë të *e-mailit* datë 30.11.2023, ankuesja ka paraqitur kundërshtimet e saj, duke parashtruar si më poshtë vijon:

Kontrata e firmosur nga rektori për vitin akademik 2023-2024 ende nuk i është vendosur në dispozicion nga burimet njerëzore. Në faqen kryesore të kontratës së firmosur është e përcaktuar në mënyrë të qartë se, kontrata duhet firmosur brenda 7 ditëve nga momenti i punësimit. Momenti i punësimit sipas ligjit 80/2015, statutit dhe rregullores zyrtare të punësimit fillon në momentin kur akti merr formën e prerë pasi miratohet nga dekani i fakultetit (rregullorja e 2016 e cituar nga rektori).

Pra, si në vitin 2022-2023 ashtu edhe në vitin 2023-2024, rektori duhej të kishte firmosur kontratën brenda 7 ditëve nga momenti i punësimit (në vitin akademik 2022-2023 kam aplikuar si pedagoge e jashtme në javën e fundit të muajit shtator, ndërsa për vitin akademik 2023-2024 kam aplikuar me datë 21.09.2023).

Në rastin e kontratës së vitit 2022-2023, rektori me shkresën nr. 3492/1 ka deklaruar se nuk ka firmosur kontratën për shkak të raportit të barrë lindjes, ndërsa në shkresën 3283/3 rektori deklaroi se për vitin akademik 2023-2024 e ka firmosur kontratën. Pse në këtë rast nuk e ka konsideruar që unë kam pasur ende të aktivizuar raportin e barrë lindjes si në rastin e kontratës së vitit 2022-2023? A nuk bie në kundërshtim me parashtrimet e dërguara në shkresën 3492/1? Për vitin akademik 2022-2023 kanë refuzuar firmosjen e kontratës për shkak të barrë lindjes, ndërsa për vitin 2023-2024 nuk e kanë konsideruar barrë lindjen si shkak për firmosjen e kontratës.

Në mars të vitit 2019 kam marrë leje lindjen e parë (viti akademik 2018-2019), e cila ka zgjatur deri në vitin 2020 dhe jam aktivizuar vetëm në fundin e vitit akademik. Në këtë rast kam nënshkruar kontratat në mënyrë të rregullt me universitetin dhe kam rregulluar ngarkesën mësimore me departamentin (për vitin akademik 2019-2020 jam aktivizuar vetëm në fundin e vitit për praktikant profesional).

Në lidhje me pretendimin se ankesat nuk janë të mbështetura në ligj, ankuesja propozon duke parashtruar se, kërkesa e parë është për përjashtimin nga doktoratura, e dyta është për mosfirmosjen e kontratave për shkak të shtatzanisë (pranuar nga rektori në shkresën nr. 3492/1) dhe e treta, ka lidhje me mosfirmosjen e kontratës si hakmarrje për shkak të ankesës së paraqitur për përjashtimin nga doktoratura, duke deklaruar shkakun e nepotizmit si pengesë kryesore për firmosjen e kontratës (shkresë zyrtare e fakultetit ekonomik). Në fakt, sipas deklaratave të drejtueses së fakultetit ekonomik, problemi i nepotizmit për vitin akademik 2023-2024 është shfaqur në mbledhjen e komisionit të doktoraturës për shqyrtimin e ankesës për përjashtimin nga doktoratura (deklaruar me gojë dhe jo me shkrim). Dy anëtarë të komisionit të doktoraturës (B.B dhe A.T), të cilat janë pjesë edhe e senatit akademik (organi më i lartë kolegjal) gjatë shqyrtimit të ankesës, kanë përmendur faktin që burri im është i punësuar në të njëjtin departament me ankuesen dhe se punësimi im është në shkelje të ligjit.

Për shkak të vonësës së firmosjes së kontratës për vitin 2023-2024 dhe problematikave që janë raportuar me gojë nga drejtuesit e fakultetit ekonomik, unë kam bërë kërkesë zyrtare për informacion mbi problemin e vonësës së firmosjes së kontratës. Në shkresën e dërguar me email nga fakulteti ekonomik, gjendet edhe kërkesa e shfuqizimit të nenit të nepotizmit nga dekani i FE, kriteri i cili është i publikuar në faqen zyrtare të universitetit. Pra, deklarata për nepotizëm është bërë nga drejtuesit e universitetit! Për të vërtetuar që universiteti ka qenë në dijeni të shfuqizimit të aktit të nepotizmit, kam dërguar tek KMD shkresën zyrtare të dërguar nga MAS në vitin 2014 dhe konfirmimin e shkresës nga ana e MAS. Nuk është hera e parë që rektorati e përdor nepotizmin si formë presioni sepse e kanë deklaruar me shkresë zyrtare në vitin 2020 kur burri im ka paraqitur disa ankesa në lidhje me shkeljet financiare dhe ligjore të drejtuesve të universitetit

Përsa i përket bazës ligjore të cituar nga rektorati, neni 45 i statutit të USH nuk ka lidhje me procedurën e punësimit, por flet vetëm për rastin kur fakulteti duhet të miratojë kritere të veçanta

që duhet të plotesojnë pedagogët e jashtëm dhe nëse i përcakton atëherë duhet të miratohen edhe nga rektori (kjo është për fazën e publikimit të kritereve dhe jo për firmosjes e kontratës).

Udhëzimi nr.371, datë 23.09.2016, i cituar nga rektori, përcakton në mënyrë të qartë se përzgjedhja e kandidatëve realizohet nga njësia bazë dhe mbikëqyret nga dekani (në asnjë pikë nuk rezulton rektori). Në rastin kur departamenti i burimeve njerëzore konstaton një gabim, nuk mund të bllokojnë firmosjen e kontratës për pedagogët e tjerë!

Shkresa me nr. 2952, datë 02.10.2023, dërguar nga rektori tek fakulteti ekonomik, nuk ka lidhje me rastin tim sepse kontratat janë dërguar nga departamenti i financë kontabilitetit me datë 06.10.2023 dhe përsëri nuk janë firmosur nga rektori.

4. Bazuar në nenin 33/8, të LMD, ku parashikohet: *“Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar.”* dhe për të sqaruar të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes, me shkresën nr.1128/3 prot., datë 18.08.2023, Komisioneri njoftoi palët për zhvillimin e një seance dëgjimore në datën 10.01.2024.

Seanca dëgjimore u zhvillua në datën 10.01.2024 me pjesmarrjen e palës ankuese, e cila u përfaqësua nga z.P.S, përfaqësues me prokurë të posaçme dhe subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa USH, përfaqësua nga znj.J.T, sipas autorizimit nr.19 prot datë 09.01.2024, lëshuar nga Rektori i USH-së.

Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesi me prokurë i palës ankuese konfirmoi se është firmosur kontrata objekt i ankesës, por për sa kohë që nuk është deklaruar në tatime kontrata nuk i shtrin efektet, pra nuk është përmbushur edhe pse ankuesja ka filluar mësimin. Nga ana e dekanit na është komunikuar që kontrata nuk u nënshkrua nga rektori për shkak të nepotizmit. Vërtetë kontrata u nënshkrua por shkresa që flet për nepotizmin është ende në fuqi.

Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesja me autorizim e USH-së, deklaroi se kontrata me ankuesen është firmosur në të njëjtën datë me të gjithë pedagogët e tjerë. Sa i takon tatimeve, ankuesja duhet t'i drejtohet Administratorit dhe jo Rektorit, pasi nuk është kompetencë e këtij të fundit. Në momentin që nga ana e fakultetit u zbatuan përcaktimet e udhëzimit, rektori ka nënshkruar kontratat për stafin akademik me kohë të pjesshme. Rektori firmos kontratën, pastaj administrata merret me procedurat e tjera për zbatimin e kontratës. Në lidhje me pretendimin për mos deklarimin në tatime, nuk kam informacion pasi nuk është ngritur si pretendim në ankesë. Nga ana jonë do të kryhen verifikimet përkatëse dhe në vijim do t'ju dërgojmë informacion.

5. Në vijim të seancës dëgjimore, nëpërmjet shkresës nr.19/1 prot datë 22.01.2024, USH depozitoi vendimin nr.259, datë 15.11.2023 *“Për aktivizim dhe deklarim të stafit akademik me kohë të pjesshme pranë FE-së”*, nr.3582 prot, datë 15.11.2023.

6. Nëpërmjet *e-mailit* të datës 06.02.2024, përfaqësuesi me prokurë të posaçme i palës ankuese, parashtroi ndër të tjera se:

Në aktet e depozituara ku pasqyrohet procedura e plotë e ndjekur nga departamenti i financë kontabilitetit për vitin 2023-2024, gjendet shkaku i deklaruar për të zgjatur afatet dhe vonuar mosfirmosjen e kontratës.

Kontrata nuk është firmosur duke u bazuar në nenin 5, pika 3.c, e rregullores për punësim të miratuar në vitin 2022. Në aneksin 2 gjeni tek pjesa djathtas lart, komentin me firmën e rektores “*FE kthehet për rishqyrtim sipas orientimit verbal, shkresor dhe rregullores*”. Pas ankesës për diskriminim për përjashtimin nga doktoratura, është gjetur si shkak dhe është përcjellë te rektorja, e cila ka firmosur edhe shkresën për të kthyer tek departamenti, i cili ka lajmëruar për arsyen e mosfirmosjes së kontratës. Pas ankesës tek Komisioneri dhe pranimit të çështjes (3 javë më vonë) kontrata është nënshkruar, por nuk është shoqëruar me veprimet detyruese që përcjell legjilacioni (deklarim në tatime dhe pagesa për orë). Nëse nuk deklarohet nuk je i punësuar zyrtarisht sipas ligjit. Për këtë arsye kërkohet që çështja të vazhdojë deri në konstatimin e diskriminimit. Deri në këto momente (data 02.02.2024) ankuesja nuk është deklaruar në sistem edhe pse e ka përfunduar procesin mësimor për semestrin e parë.

7. Nëpërmjet *e-mailit* të datës 06.03.2024, përfaqësuesi me prokurë të posaçme i palës ankuese, depozitoi kopje të shkresës nr.509 prot., datë 13.02.2024 me lëndë “*Relacion i mbledhjes së Rektoratit, datë 13.02.2024*” të Rektorit të USH-së. Pala ankuese deklarohet se, shkresa e rektoratit, e cila kërkon nga burimet njerëzore që të verifikojnë stafin akademik për lidhjet familjare, për pedagogët që punojnë në të njëjtën njëzi bazë, tregon se neni i nepotizmit është në fuqi dhe do të marrin masa për të ndëshkuar edhe pse neni është i shfuqizuar nga gjykata kushtetuese.

Analiza ligjore e fakteve dhe rrethanave.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri konstaton se, nëpërmjet ankesës objekt shqyrtimi, pala ankuese pretendon se është diskriminuar nga ana e USH për shkak të “gjendjes familjare” dhe në kuadër të termit “çdo shkak tjetër” për shkak të ankesës që ka paraqitur bashkëshorti i saj z. P.S kundër Universitetit. Diskriminimi i pretenduar nga pala ankuese konsiston në faktin që USH nuk nënshkruan kontratën e punës me kohë të pjesshme, si staf akademik me kohë të pjesshme për vitin akademik 2023-2024. Nëpërmjet ankesës objekt shqyrtimi, pala ankuese ka kërkuar nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit dhe detyrimin e USH-së për firmosjen e kontratës si pedagoge e jashtme.

Gjatë shqyrtimit të ankesës rezultoi e provuar se, midis ankueses S.S dhe USH-së është nënshkruar në datën 09.11.2023 kontrata e punës me kohë të pjesshme (nr.3506 prot), për

punësimin e ankueses si personel akademik me kohë të pjesshme pranë USH-së. Kohëzgjatja e kësaj kontrate është me afat të caktuar për vitin akademik 2023-2024.

Nëpërmjet vendimit nr. 259, datë 15.11.2023 “Për aktivizim dhe deklarim të stafit akademik me kohë të pjesshme pranë FE-së” (nr.3582 prot datë 15.11.2023), të Rektorit të USH-së, është vendosur: *“1. Aktivizimin e të gjithë pedagogëve të poshtëshënuar si staf akademik me kohë të pjesshme për vitin akademik 2023-2024. 2. Deklarimin “on-line” në sistemin elektronik të DRT të pedagogëve që do të zhvillojnë mësim në FE për semestrin e parë dhe/ose të dytë sipas listës bashkëlidhur. 3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i përcillet për zbatim Zv.Rektorit akademik, Administratorit, dekanit të FE-së, Drejtorisë Juridike dhe Burimeve njerëzore”*. Referuar listës së pedagogëve me kohë të pjesshme që do të angazhohen si staf akademik gjatë vitit akademik 2023-2024, që i bashkëlidhet këtij vendimi rezulton e përfshirë edhe ankuesja, e listuar e 19, nga 21 pedagogë në total që përmban kjo listë.

Sa më sipër Komisioneri vlerëson se, kërkimi i palës ankuese, ose ajo që pala ankuese kërkon të arrijë ose të sigurojë, nëpërmjet paraqitjes së ankesës objekt shqyrtimi dhe fillimit të kësaj procedure administrative është përmbushur, nëpërmjet nënshkrimit midis ankueses dhe USH-së të kontratës së punës me kohë të pjesshme, në datën 09.11.2023.

Nga tërësia e akteve të administruara, konstatohet se, mosnënshkrimi i kontratës nuk ka qenë vetëm kundrejt ankueses, por kundrejt gjithë lektoreve me kohe të pjesshme.

Në këtë mënyrë, në kushtet kur kërkimi i ankesës së palës ankuese, që në rastin konkret është detyrimi i USH për të firmosur kontratën si pedagoge me kohë të pjesshme pranë Fakultetit Ekonomik në USH, është përmbushur, pra është realizuar nëpërmjet nënshkrimit të kontratës midis palëve në datën 09.11.2023, Komisioneri vlerëson se, objekti ose qëllimi për të cilin ka nisur procedura administrative mbi bazën e ankesës së paraqitur nga pala ankuese, është bërë tashmë i pamundur për shkak se objekti i ankesës nuk ekziston pasi ai tashmë është realizuar.

Në lidhje me pretendimin e palës ankuese se, ajo nuk është deklaruar nga ana e USH në cilësinë e punëdhënësit pranë organeve tatimore dhe rrjedhimisht kontrata e firmosur nuk është efektive dhe ajo nuk konsiderohet e punësuar sipas ligjit, nuk janë objekt i ankesës në shqyrtim, objekt i cili konsiston pikërisht në firmosjen e kontratës midis palëve, kontratë e cila rezulton të jetë nënshkruar në datë 09.11.2023 dhe sipas deklarimeve edhe të palës ankuese, kjo e fundit është angazhuar rregullisht si pedagoge sipas përcaktimeve kontraktuale. Komisioneri vlerëson se, pretendimet e palës ankuese në lidhje me mosdeklarimin e kontratës së punës pranë organeve tatimore, kanë të bëjnë me një moment të ndryshëm nga lidhja e kontratës së punës. Këto pretendime kanë të bëjnë me zbatimin dhe përmbushjen e detyrimeve ligjore që kanë palët si rrjedhojë e hyrjes në një marrëdhënie kontraktuale punësimi.

Në nenin 32, pika 3, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar përcaktohet: *“3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, komisioneri zbaton normat e*

parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj.”

Në nenin 90, “Përfundimi i procedurës administrative”, pika 3, të Kodit të Procedurave Administrative, sanksionohet se: “3. *Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrative.*”. Ndërsa, në nenin 95 “Pamundësia në objekt apo qëllim”, të Kodit të procedurave Administrative, parashikohet si vijon: “*Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur.*”

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, procedura për shqyrtimin e ankesës Nr. 219 regj, datë 18.10.2024, e paraqitur nga pala ankuese znj.S.S, kundër USH-së, nuk mund të vazhdojë, por duhet të deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar, për shkak se objekti dhe qëllimi i ankesës për të cilin ka nisur procedura është bërë i pamundur, për sa kohë që ajo që objekti dhe qëllimi që pala ankuese ka kërkuar të realizojë nëpërmjet kësaj procedure administrative është përmbushur.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a” dhe pika 3, nenin 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, nenin 90, pika 3 dhe nenin 95, të Kodit të Procedurave Administrative, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Të deklarojë të përfunduar pa një vendim përfundimtar, procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr.219 Regjistri, datë 18.10.2023, të paraqitur nga pala ankuese znj.S.S kundër Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, për shkak se objekti dhe qëllimi i ankesës për të cilin ka nisur procedura është bërë i pamundur.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Shkaku: gjendja familjare, çdo shkak tjetër

Fusha: punësim

Lloji i vendimit: Ndërprerje procedure_Pamundësi në objekt dhe qëllim)